

PËRFITIMET DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË FORUMIT KULTUROR

Rrjeti i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës – Forumi Kulturor i Kosovës është një iniciativë e përbashkët e organizatave të skenës së pavarur kulturore në Kosovë me synim që të arrijë që ky sektor të jetë sa më i begatë, i larmishëm, me ndikim, i pavarur i qëndrueshëm, pro aktiv dhe me ndikim përmes aktiviteteve të vetë-organizimit, të rrjetëzimit, konsolidimi të zërit të përbashkët, mbështetjes dhe ndarjes reciproke të përvojës, ndërtimit të kapaciteteve si dhe nëpërmjet avokimit për njohjen dhe përfshirjen e sektorit kulturor në proceset e vendimmarrjes.

Misioni

- Krijimi i një rrjeti të organizatave të pavarura kulturore që është i konsoliduar, efikas, funksional, gjithëpërfshirës e i qëndrueshëm dhe që përfaqëson zërin e artikulluar dhe interesat e organizatave të pavarura të kulturës në Kosovë.
- Fuqizimin e organizatave të pavarura kulturore duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e programeve të tyre
- Afirmimin e organizatave anëtare.
- Përfshirjen e organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse
- Rritjes së përkrahjes të skenës së pavarur të kulturës.
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Aktivitetet kryesore:

- Komunikimin dhe rrjetëzimin e organizatave të pavarura në fushën e kulturës.
- Shkëmbimin dinamik të informacioneve dhe të përvojave.
- Aktivitete të lobimit dhe avokimit
- Trajnime specifike për nevojat e organizatave anëtare
- Organizimin e debateve dhe forumeve
- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore

Përfitimet e anëtarëve të rrjetit janë:

- Mundësi të promovimit të organizatës brenda dhe jashtë rrjetit
- Mundësi të zhvillimit të bashkëpunimit me organizatat anëtare dhe organizata tjera vendore e ndërkombëtare
- Qasje në trajnime, seminare dhe takime të organizuara nga rrjeti.
- Qasje për ndihmë financiare për udhëtime profesionale jashtë vendit si dhe ndihmë edhe për aktivitete tjera kur krijohen mundësi.
- Përparësi në partneritet për organizime të ngjarjeve të ndryshme, në të cilat përfshihet rrjeti.
- Informim ekskluziv për ngjarjet kulturore brenda dhe jashtë shtetit.
- Informim ekskluziv për mundësitë e aplikimit për fonde të donatorëve.
- Informim ekskluziv për mundësitë të krijimit të partneriteteve ndërkombëtare e rajonale.

Obligimet e anëtarëve të rrjetit janë:

- Të marrë pjesë aktivisht në Kuvendin e anëtarëve të rrjetit, në raste të pamundësisë së prezencës vota mund të delegohet te një organizatë tjetër anëtare.
- Të respektojë vendimet e marra nga Kryesia e zgjedhur nga Kuvendi i Anëtarëve. Kryesia e zgjedhur ka mandat 3 vjeçar deri në vitin 2015 dhe përbëhet nga:
 - Florent Mehmeti (Teatri ODA), Kryetar i Forumit Kulturor dhe anëtarët e kryesisë:
 - Aliriza Arenliu (Doku Fest);
 - Hajrullah Çeku (Ec Ma Ndryshe);
 - Besa Luzha (Kosovo Chopin Association)
 - Shkëlzen Maliqi (Qendra për Studime Humanistike “Gani Bobi”)
- Të promovojë Forumin Kulturor dhe punën e tij në mënyrë të denjë përballë partnerëve të tjerë relevant me të cilët punon organizata.
- Të respektoj rregulloret e punës dhe ato financiare të rrjetit si dhe rregullat tjera që i parasheh statuti.
 - Kuvendi i Anëtarëve ka marr vendim që anëtarësia në Forumin Kulturor të jetë me pagesë. Lartësia e pagesës vjetore të anëtarësisë do të aprohet në Kuvendin e ardhshëm të Anëtarëve dhe propozimi është:

Qarkullimi vjetor i organizates	Pagesa vjetore EUR
Deri 50,000 €	50
50,000 deri 100,000 €	100
100,000 deri 200,000 €	150
200,000 deri 750,000 €	200
Mbi 750,000 €	300
Anëtar i asocuar	1100

Fillimisht për t'u anëtarësuar duhet të paraqitet kërkesa drejtuar Kryesisë së Forumit Kulturor nëpërmjet e-mail adresës info@forumikulturor.net ose drejtpërdrejtë në zyret e Teatrit ODA. Pas aprovimit të kërkesës, përgatitet dosja e organizatës dhe sipas Statutit Kuvendi i Anëtarëve e miraton anëtarin e ri.